



REPUBLIKA E SHQIPERISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 50 Prot

Tiranë, më 13/10/11

Lënda : Mbi kundërvajtjen administrative të kontrolluesit **ALBTOURS D sh.p. k. Tiranë.**

Adresa: Rruga “4 Shkurti “ tek ish blloku Tiranë.

VENDIM

Nr. 13 , datë 13/10/11

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr. 211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit **ALBTOURS D sh.p.k. Tiranë.**

KONSTATOVA

Sipas ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, ju keni cilësinë e Kontrolluesit, pra përgjegjësinë për përpunimin e të dhënave personale dhe si i tillë keni detyrimin të zbatoni të gjitha kërkesat e këtij ligji dhe në mënyrë të veçantë të detyrimit të parashikuar në nenin 21 të tij.

Në pikën 1 të nenit 21 të ligjit të sipërm parashikohet: “Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë. Ndërsa në nenin 22 saktësohet përmbajtja e të dhënave që përpunoni, të cilat duhet t’i njoftoni tek Komisioneri.

Për zbatimin e këtij detyrimi nga ana e jonë, me shkresën nr. 3847 prot, datë 03/09/2010, ju është dërguar një informacion me shpjegimet se si do të plotësoni formularin e njoftimit të të dhënave personale që përpunoni, duke ju caktuar një afat për plotësimin e këtij detyrimi, datë 04/10/2010.

Po kështu, nga verifikimi e regjistrave të Drejtorisë së Regjistrimit të këtij institucioni rezulton se deri më datë 12.10.2011, ende nuk keni depozituar formularin e plotësuar të njoftimit.

Moskryerja e kësaj detyre ju ngarkon me përgjegjësi administrative të parashikuar në nenin 39 pika 1, germa “d”, të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, ku parashikohet dënimi me gjobë nga 10.000 deri në 50.000 lekë.

Për zgjedhjen e masës së gjobës Komisioneri ka parasysh shkallën e njohjes dhe masat që keni marrë për implementimin e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Nisur sa më sipër, në zbatim të neneve 21-23, 30/2, 39/1,4; 40 e 41, të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të K. Pr. Administrative

V E N D O S A

1. Dënimin e Kontrolluesit, **ALBTOURS D sh.p.k. Tiranë**, me gjobë 30.000 (tridhjetë mijë) lekë.
2. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 ditë nga komunikimi i këtij vendimi.
Me kalimin e këtij afati, ky vendim shndërrohet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.

Ky vendim u dha sot me datë 13.10.2011.

Komisioneri

Flora Çabej (Pogaçe)

